



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE, SHËRBIMËVE E STATISTIKËS**

Nr. _____ Prot.

Fier, më ____ . ____ . 2022

RAPORT MONITORIMI

DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER

PËRMBLEDHËSE

(JANAR – DHJETOR 2021)

Detajimi i buxhetit për vitin 2021 është mbështetur në Programin Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 si dhe në prioritetet e përcaktuara në Programin e Qeverisë. Detajimi i fondeve për vitin 2021 është realizuar sipas tre programeve buxhetore ose niveleve arsimore ku janë mbajtur parasysh objektivat, qëllimi i synuar, përfituesit, në synim të objektivave të programit të Qeverisë Shtator 2020, objektivave të përcaktuara në strategjinë e arsimit dhe Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2022 dhe strategjinë e arsimit parauniversitar, si dhe kërkesave për imlementimin e ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Monitorimi i buxhetit të 8 mujorit 2021 është procesi i vlerësimit të performancës, i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me treguesit e planifikuar dhe ka për qëllim:

- Të ofrojë shërbim cilësor në sistemin arsimor parauniversitar nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe inspektimit.
- Të organizojë punën për menaxhimin, ndjekjen dhe kontrollin e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Të koordinojë administrimin e burimeve njerëzore në institucionet arsimore të varësisë, sipas legjislacionit në fuqi.
- Të sigurojë se funksionet e lidhura me planifikimin, zbatimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar për institucionet publike në juridiksionin e saj të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Të vlerësojë nëpërmjet ZAVP-ve, kërkesat e ministrisë përgjegjëse për arsimin si dhe të shqyrtojë për përmbushjen e kritereve infrastrukturore për hapjen e institucioneve arsimore dhe ushtrimin e veprimtarisë në fushën e arsimit parauniversitar.
- Të sigurojë zbatimin e kurrikulës, metodologjitë dhe standardet që mbështesin dhe përmirësojnë procesin e ofrimit të shërbimit arsimor.
- Të ofrojë ekspertizë teknike në hartimin e metodologjive mësimore, praktikave dhe teknikave që përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies.
- Të menaxhojë dhe mbikëqyr/kontrollon institucionet arsimore parauniversitare lidhur me zhvillimin e veprimtarive mësimore.
- Të monitorojë kualifikimet e personelit mësimdhënës për kurrikulën, metodologjitë dhe standardet e përcaktuara nga institucioni përgjegjës.
- Të menaxhojë me përgjegjësi rekrutimin e mësuesve nëpërmjet menaxhimit, mirëmbajtjes, përditësimit të portalit kombëtar “Mësues për Shqipërinë”, ndjekjen e procedurave përkatëse të konkurrimit, përpunimin e analizimit e të dhënave dhe shpalljen e rezultateve.
- Të organizojnë dhe mbështesin shërbimin psikosocial në institucionet arsimore publike.

- Të garantoj mirë administrimin e burimeve financiare dhe alokimin e tyre në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nevojat e institucioneve arsimore bazuar në formulën “për nxënës”.
- Të bashkëpunojë me njësitë e vetëqeverisjes vendore për planifikimin, realizimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së institucioneve arsimore.
- Të monitorojë procedurat për përzgjedhjen, shpërndarjen dhe pajisjen e nxënësve me tekste shkollore.
- Të organizoj dhe mbështes zhvillimin e provimeve dhe vlerësimeve kombëtare dhe ndërkombëtare në arsimin parauniversitar.
- Të inspektojnë, monitorojnë, vlerësojnë, rekomandojnë dhe nxjerrin përfundime mbi zbatueshmërinë e kriterëve të ligjshmërisë nga institucionet arsimore parauniversitare publike dhe private.
- Të mbledh dhe përpunoj të dhënat statistikore nga institucionet arsimore në juridiksionin e tyre.
- Të krijojë një sistemi të përshtatshëm, efektiv dhe eficient të MFK-së konform standardet ligjore, nëpërmjet menaxhimit me bazë performance. Eficenca në përdorim e burimeve financiare e materiale në arsim; efektiviteti në përdorimin e burimeve njerëzore: rritja e kapaciteteve e aftësive menaxhuese në nivelin rajonal (DAR/ ZA), lokal (institucionet arsimore)
- Të vendos mekanizma transparente të monitorimit të përdorimit të fondeve buxhetore në zbatim të akteve ligjore e nënligjore të sistemit arsimor në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Të rrisë dhe zhvillojë kapacitetet planifikuese dhe menaxhuese, nëpërmjet programeve trajnuese

Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Fier dhe 13 ZVAP-e në juridiksion të saj kanë filluar aktivitetin më 20.05.2019, bazuar në VKM nr. 99, datë 27.02.2019 *“Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të drejtorisë së përgjithshme të arsimit parauniversitar”* dhe në Urdhërin të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr 234, datë 19.04.2019 *“Për miratimin e strukturës dhe të organikës së zyrave vendore të arsimit parauniversitar”*

Buxheti i DRAP Fier dhe 13.ZVA-et në juridiksion është mbështetur në programin buxhetor afatmesëm 2021-2023 dhe në fondet buxhetore të alokuara për vitin 2021 dhe të rishikuar gjatë vitit 2021, si dhe në prioritetet e përcaktuara në programin e qeverisë, i cili ndahet në tre programe si më poshtë:

- **01110 - Planifikim menaxhim**
- **09120 - Arsimi Bazë**
- **09320 - Arsimi i Mesëm (i përgjithshëm)**

Monitorimi i buxhetit të vitit 2021 është realizuar në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2021”, të ligjit nr. 10296 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 të Ministrit të Financave “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 ”Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar , si dhe Udhëzimit Plotësues nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”.

Zbatimi i buxhetit të shtetit, në përputhje me dispozitat ligjore. Realizimi i treguesve të buxhetit, analizimi dhe krahasimi me vitet e kaluara.

DRAP Fier dhe 13 ZVA-et në juridiksion të saj është përgjegjëse për funksionimin dhe mbarëvajtjen e institucioneve arsimore brenda juridiksionit të tyre, duke siguruar cilësinë e shërbimit arsimor parauniversitar në nivel rajonal dhe kryen disa detyra të përcaktuara një ndër to është “*Garantimi i miradministrimit të burimeve financiare dhe alokimit të tyre, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nevojat e institucioneve arsimore*”.

Për të përmbushur detyrat ne kemi bërë parashikimet e nevojshme buxhetore, kemi hartuar projekt-buxhetin afatmesëm 2021-2023 sipas nevojave të institucionit dhe e kemi dërguar pranë MASR.

Në vijim po ju paraqesim fondet e akorduara dhe realizimet e shpenzimeve buxhetore në total dhe për cdo program buxhetor, sipas produkteve dhe llogarive ekonomike.


Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Fier, po administron dhe menaxhon për vitin 2021 fondet buxhetore të rishikuara, për 13 ZVAP në vartësi të saj sipas llojit të shpenzimeve, në total 5 miliard 948 milionë e 911 mijë lekë , krahasuar me shpenzimet faktike të 2020 në 5,356,111 ose 11 % ose 592 milion 800 mijë leke më i madh se fakti i 2020 të ndarë për paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime të tjera, ku peshën më të madhe e zënë pagat dhe sigurimet me 80.7 % dhe 13.6 %, kurse 602 zë vetëm 2.5 % dhe 231 zë 1 % ndaj planit total.

Pesha specifike e shpenzimeve

Emertimi	Plani 2021	Peshe specifike
Paga	4,803,415	80.7%
Sigurime	808,313	13.6%
Shpenzime	151,146	2.5%
Transferta	182,538	3.1%
Kapitale të Trupëzuara	3,500	0.1%
Totali	5,948,911	100%

Më poshtë po paraqesim grafikisht sasinë e planit të rishikuar 2021 të ndarë përkatësisht për paga, sigurime dhe shpenzime të tjera.


Peshe specifike e shpenzimeve të planifikuara



Sasia dhe pesha specifike që ka cdo ZVAP është në vartësi të numrit të mësuesve dhe nxënësve, ku peshën më të madhe e kanë Fieri me 20.3 %, Vlora me 17.7 % dhe Lushnja 14.5% Kurse peshën më të vogël e ka DRAP Fier me 0.3 % dhe Finiq Dropull me 1.6 %.

Peshe specifike	Shuma	Institucioni
0.3%	19,832	Drap Fier
20.3%	1,206,724	Fier
3.6%	213,928	Patos
4.0%	240,289	Roskovec
5.3%	316,922	Mallakastra
14.5%	862,207	Lushnja
6.8%	405,377	Divjake
17.7%	1,050,648	Vlora
3.8%	226,007	Selenica
5.2%	306,987	Tepelena
3.7%	218,473	Permet
6.2%	368,074	Gjirokastr
7.0%	417,163	Saranda
1.6%	96,280	Finiq-Dropull
100%	5,948,911	Totali

Paraqitja e peshes specifike që ka cdo institucion nda planit total të rishikuar 2021



Edhe paraqitja grafike shpreh qartë peshën specifike si në tabelë.

Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Fier, ka realizuar fondet buxhetore, sipas tre programeve të miratuara, si më poshtë:

DRAP Fier ka **realizuar për vitin 2020** në total fondin prej 5 miliard 356 milion e 111 mijë lekë të ndarë sipas programeve të Planifikim menaxhimi 10110 në shumën 86 milion 732 mijë lekë, në arsimin bazë 4 miliard 107 milion 519


mijë lekë, kurse në arsimin e mesëm ka realizuar fondin prej 1 miliard 161 milion 860 minë lekë, pra peshën më të madhe e zë Arsimi bazë.

Per **vitin 2021 plani total i rishikuar** është 5 miliard 948 milionë e 911 mijë lekë ose 591 milion 800 mijë lekë më shumë se realizimi i vitit 2020. Edhe këtë vit sasinë më të madhe të planit e ka Arsimi bazë vlerën 4 miliard 580 milion 386 mijë lekë, kurse sasinë më të vogël e ka planifikim menaxhimi , në vlerën 113 milion 532 mijë lekë.


Realizimi i vitit 2021, krahasuar me planin e rishikuar të këtij viti është 5 miliard 931 milion 168 mijë lekë nga 5 miliard 948 milionë e 911 mijë lekë plani ose 97 %. Programi 10110 është realizuar në masën 111 milion 016 mijë lekë nga 113 milion 532 mijë lekë plani ose 97.8 % , Arsimi bazë është realizuar në masën 4 miliard 569 milion 547 mijë lekë nga 4 miliard 580 milion 386 mijë lekë plani ose 99.8 % dhe Arsimi i mesëm është realizuar në masën 1 miliard 250 milion 605 mijë lekë nga 1 miliard 254 milion 993 mijë plani ose 99.7 %.

Emertimi	Fakti 2020	Plani 2021	Fakti 4M	Real. %F/Planit
Programi 01110	86,732	113,532	111,016	97.8%
Programi 09120	4,107,519	4,580,386	4,569,547	99.8%
Programi 09230	1,161,860	1,254,993	1,250,605	99.7%
Totali	5,356,111	5,948,911	5,931,168	99.7%

Më poshtë po paraqesim grafikun e tabelës për të krahasuar realizimin 2020 me planin e rishikuar 2021.



Krahasimin e realizimit vjetor me planin e rishikuar të vitit 2021 po e paraqesim në grafikun e mëposhtëm.



Edhe në grafik duket qarte se peshen specifike e zë Arsimi Bazë. Tani vazhdojmë me një analizë më të hollësishme sipas programeve.

1. Planifikim menaxhimi 10110

Në programin 10110 në DRAP Fier (për 14 institucionet) plani i rishikuar i vitit 2021 në total është 113 milion 532 mijë lekë nga 86 milion 732 mijë lekë realizimi i vitit 2020, pra më i madh , me nje rritje në vlerën 26 milion 800 mijë lekë . Ky plan është celur sipas kodeve të produkteve , ku vendin kryesor e zë produkti Veprimtari e MASR sipas kërkesave ligjore me kodin 91101AE me shumën 110 milion 085 mijë lekë ose 97. % e totalit i ndjekur nga punonjes dhe specialist te trajnuar me kod produkti 91101AA në shumën 2 milion 037 mijë lekë ose 2 % dhe produkti Drejtues të institucioneve arsimore të trajnuar me kodin 91101AC në shumën 1 milion 560 mijë lekë ose 1 % nga totali.

Realizimi i vitit 2021 krahasuar me planin e celur të këtij viti në programin 10110 në total është 111 milion 166 mijë lekë nga 113 milion 681 mijë lekë plani ose 98 %. Në kodin e produktit 91101AE është realizuar në shumën 108 milion 167 mijë lekë nga 110 milion 085 mijë lekë plani ose 98 %. Në kodin e produktit 91101AA është realizuar në shumën 1 milion 741 mijë lekë nga 2 milion 037 mijë lekë plani ose 85 %.

Këto të dhëna paraqiten në tabelën e mëposhtëme

K.Produktit	Fakti 2020	Plani 2021	Fakti 2021	P,spec Pl.	% F/Pl
91101AA	1,301	2,037	1,741	2%	85%
91101AC	828	1,560	1,258	1%	81%
91101AE	84,603	110,085	108,167	97%	98%
Totali	86,732	113,681	111,166	100%	98%

Më poshtë është paraqitja grafike e të dhënave




Tabela e situacionit të shpenzimeve për personelin dhe pesha specifike ndaj totalit

Art.	Emërtimi	Fakti i vitit paraardhës	PBA Viti 2021	Plan i Rishikuar Viti 2021	Fakti I periudhës progresive	% F / PI
600	Paga	64,007	94,230	83,301	82,335	98.84%
601	Sigurimet	10,820	15,028	14,551	14,183	97.47%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	11,875	26,051	15,280	14,097	92.26%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	30	14	400	400	100.00%
	Totali	86,732	135,323	113,532	111,016	97.78%
600	Paga	73.80%	69.63%	73.37%	74.17%	
601	Sigurimet	12.48%	11.11%	12.82%	12.78%	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	13.69%	19.25%	13.46%	12.70%	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	0.03%	0.01%	0.35%	0.36%	
	Totali	100%	100%	100%	100%	

Fondet e rishikuara për personelin janë 113 milion e 532 mijë lekë nga 86 milion 732 mijë lekë realizuar në 2020 ose me shtesë 30 %.

Fondi i pagave zë peshën 73.4 %, sig.shoqërore 12.8 %, shpenzimet për mallra e shërbime të tjera 13.5 % dhe transfertat për buxhetin familiar 0.3 %.

Fondi pagave është realizuar 98.8 % , sigurimet shoqërore janë realizuar 97.5 % ndaj planit të rishikuar. Shpenzimet për mallra e shërbime janë realizuar 92.2 % dhe transfertat për buxhetin familiar 100 % .

2. Arsimi Bazë 09120

Në programin 09120 në DRAP Fier (për 14 institucionet) **plani i rishikuar i vitit 2021** në total është 4 milion 578 milion 586 mijë lekë nga 4 milion 107 milion 519

mijë lekë realizimi i vitit 2020, pra më i lartë, në vlerën 471 milion 067 mijë lekë.

Ky plan është celur sipas kodeve te produkteve , ku vendin kryesor e zë produkti nxënës përfitues të shërbimit arsimor ne sistemin 9 vjecar me kodin 91103AB me shumën 4 miliard 285 milion 255 mijë lekë ose 93.557 % e totalit i ndjekur nga produkti nxënës dhe mësues që u garantohe shërbimi i transportit me kod 91103AD në shumën 293 milion 094 mijë lekë ose 6.399 % nga totali i njekur nga kodi 91103AE në shumën 237 mijë lekë ose 0.005 % dhe të fundit me kodin M112624 në shumën 1 milion 800 mijë lekë ose 0.039 % nga totali.

Realizimi i vitit 2021 krahasuar me planin e celur të këtij viti në programin 09120 në total është 4 miliard 569 milion 545 mijë lekë nga 4 miliard 580 milion 386 mijë lekë plani ose 100 %.

Në kodin e produktit 91103AB është realizuar në shumën 4 miliard 276 milion 557 mijë lekë nga 4 miliard 285 milion 255 mijë lekë plani ose 100 %.

Në kodin e produktit 91103AD është realizuar në shumën 291 milion 216 mijë lekë nga 293 milion 094 mijë lekë plani ose 99 %. Në kodin e produktit 91103AE është realizuar në shumën 000 lekë nga 237 mijë lekë plani ose 0 %,

Në kodin e produktit M112624 është realizuar në shumën 1 milion e 772 mijë lekë nga 1 milion 800 mijë lekë plani ose 100 %.

Këto të dhëna paraqiten në tabelën e mëposhtëme

K.Produktit	Fakti 2020	Plani 2021	Fakti 2021	P,spec Pl.	Pl% F/
91103AB	3,898,276	4,285,255	4,276,557	93.557%	100%
91103AD	193,493	293,094	291,216	6.399%	99%
91103AE	0	237	0	0.005%	0%
91103AG	15,750	0	0	0.000%	100%
M112624	0	1,800	1,772	0.039%	0%
Totali	4,107,519	4,580,386	4,569,545	100.000%	100%

Më poshtë është paraqitja grafike e të dhënave




Tabela e situacionit te shpenzimeve arsimin bazë dhe pesha specifike ndaj totalit

Art	Emërtimi	Fakti i vitit paraardhes Viti 2019	PBA Viti 2020	Plan i Rishikuar Viti 2020	Fakti i Periudhes/progresiv	% F / P i Periudhes/progresiv
600	Paga	3,329,531	3,754,697	3,667,954	3,661,816	99.83%
601	Sigurimet	557,173	599,093	616,259	614,740	99.75%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	98,124	174,968	124,781	122,781	98.40%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	122,691	105,870	169,592	168,435	99.32%
231	Kapitale të Trupëzuara	0	66,335	1,800	1,772	98.43%
	Totali	4,107,519	4,700,963	4,580,386	4,569,545	99.76%
600	Paga	81.06%	79.87%	80.08%	80.14%	
601	Sigurimet	13.56%	12.74%	13.45%	13.45%	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	2.39%	3.72%	2.72%	2.69%	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	2.99%	2.25%	3.70%	3.69%	
231	Kapitale të Trupëzuara	0.00%	1.41%	0.04%	0.04%	
	Totali	100%	100%	100%	100%	

Fondet e rishikuara për arsimin bazë janë 4 miliard 580 milion e 386 mijë lekë nga 4 miliard 107 milion e 519 mijë realizuar në 2020 ose me shtesë 99.8 %.

Fondi i pagave zë peshën 80.08 %, sig.shoqërore 13.45 %, shpenzimet për mallra e shërbime të tjera 2.72 % , transferta për buxhetin familiar 3.7 % dhe shpenzime kapitale 0.04%

Fondi pagave është realizuar 99.8 % ndaj planit të rishikuar, sigurimet shoqërore janë realizuar 99.8 % ndaj planit të rishikuar. Shpenzimet për mallra e shërbime janë realizuar 98.4 % dhe shpenzimet për transfert te individet është realizuar 99.32 %, kurse shpenzimet kapitale janë realizuar 98.4 %.

3. Arsimi Mesëm 09230

Në programin 09230 në DRAP Fier (për 14 institucionet) plani i rishikuar i vitit 2021 në total është 1 miliard 254 milion 992 mijë lekë nga 1 milion 161 milion 858 mijë lekë realizimi i vitit 2019, pra më i lartë, në vlerën 93 milion 133 mijë lekë.

Ky plan është celur sipas kodeve të produkteve , ku vendin kryesor e zë produkti Nxënës që regjistrohet dhe ndjekin arsimin e mesëm të lartë në institucionet asimore publike me kodin 91104AA me shumën 1 miliard 229 milion 672 mijë lekë ose 98 % e totalit i ndjekur nga produkti Mësues të AML që përfitojnë shërbimin e transportit me kod 91104AB në shumën 23 milion 621 mijë lekë ose 1.9 % nga totali, mësues të arsimit mesëm të trajnuar për kurrikulën e re me kodin 91104AC në shumën 0 mijë lekë ose 0. % nga totali, dhe kodi M112629 shpenzimet kapitale 1 milion e 700 mijë lekë ose 0.1 %.

Realizimi i 4M.II i të vitit 2021, krahasuar me planin e rishikuar të këtij viti në programin 09230 në total është 1 miliard 250 milion 601 mijë lekë nga 1 miliard 254 milion 993 mijë lekë plani ose 100 %.

Në kodin e produktit 91104AA është realizuar në shumën 1 miliard 225 milion 923 mijë lekë nga 1 miliard 229 milion 672 mijë lekë plani ose 100 %. Në kodin e produktit 91104AB është realizuar në shumën 23 milion 105 mijë lekë nga 23 milion 621 mijë lekë plani ose 98 %. Në kodin e produktit 91104AC është realizuar në shumën 000 mijë lekë nga 2 mijë lekë plani dhe ne kodin M112629 është realizuar në shumën 1 milion e 573 mijë lekë nga 1 milion e 700 mijë lekë plani ose 93 %

Këto të dhëna paraqiten në tabelën e mëposhtëme

K.Produktit	Fakti 2020	Plani 2021	Fakti 2021	P,spec Pl.	PI% F/
91104AA	1,140,244	1,229,672	1,225,923	98.0%	100%
91104AB	21,537	23,621	23,105	1.9%	98%
A91104AC	78	0	0	0.0%	#DIV/0!
A91104AE	0	0	0	0.0%	#DIV/0!
M112629	0	1,700	1,573	0.1%	93%
Totali	1,161,859	1,254,993	1,250,601	100.0%	100%

Më poshtë është paraqitja grafike e të dhënave




Tabela e situacionit te shpenzimeve arsimin bazë dhe pesha specifike ndaj totalit

Art.	Emertimi	Fakti i vitit paraardhes Viti 2020	PBA Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	Fakti i Periudhes/ progresiv	% realizimit faktitndaj planit i Periudhes/ progresiv
600	Paga	972,627	1,111,601	1,052,160	1,049,181	99.72%
601	Sigurimet	165,078	177,067	177,502	176,743	99.57%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	11,437	28,384	11,084	10,638	95.97%
231	Trans per Buxh. Fam. & Individ	12,717	22,524	12,546	12,467	99.37%
606	Shp.kapitale	0	11,746	1,700	1,573	92.54%
	Totali	1,161,859	1,351,322	1,254,993	1,250,601	99.65%
600	Paga	83.71%	82.26%	83.84%	83.89%	
601	Sigurimet	14.21%	13.10%	14.14%	14.13%	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	0.98%	2.10%	0.88%	0.85%	
231	Trans per Buxh. Fam. & Individ	1.09%	1.67%	1.00%	1.00%	
606	Shp.kapitale	0.00%	0.87%	0.14%	0.13%	
	Totali	100%	100%	100%	100%	

Fondet e rishikuara për arsimin e mesëm janë 1 miliard 254 milion 993 mijë lekë nga 1 miliard 161 milion e 859 mijë realizuar në 2020 ose me shtesë 12 %.

Fondi i pagave zë peshën 83.8 %, sig.shoqërore 14.14%, shpenzimet për mallra e shërbime të tjera 0.9 % dhe transfertat për buxhetin familiar 1 % dhe 231 në masën 0.14 %

Fondi pagave është realizuar 99.7 % ndaj planit të rishikuar, sigurimet shoqërore janë realizuar 99.6 % ndaj planit të rishikuar. Shpenzimet për mallra e shërbime janë realizuar 96 % , Trans për Buxh. Fam. & Individ u realizua 99.4 % dhe 231 në masën 92.5 %.

Analizën e shpenzimeve 602 për 14 institucionet e DRAP Fier për 4M.II 2021 po e paraqesim në tabelën e mëposhtme:

SHPENZIMET	TOTALI	10110	09120	09230	
Plani 602	151,146	15,280	124,781	11,084	
Fakti 602	147,516	14,097	122,781	10,638	100%
Dieta	2,438	2,438			1.65%
Telefon, internet	259	259			0.18%
Energji ,uje, poste	2,611	2,611			1.77%
Taksa vendore te bashkise	628	628			0.43%


Karburant	2,852	2,852			1.93%
Materiale kancelarie	1,094	1,094			0.74%
Blerje tonerash	644	644			0.44%
Materiale pastrimi	400	400			0.27%
Shpenzime të tjera gjatë vitit	948	948			0.64%
Riparim pjese kembimi	319	319			0.22%
Taksa dhe siguracion mjete	189	189			0.13%
Materiale shtypshkrime,ftesa,certifikata etj	71	71			0.05%
Shërbime per mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrave	114	114			0.08%
Shërbime të printimit dhe publikimit	64	64			0.04%
Qera objekti	471	471			0.32%
Vendime gjyqi	2,032	995	1,037		1.38%
Transport mesues, nxenes	132,382		121,744	10,638	89.74%

Nga të dhënat e tabelës shohim që nga 147 milion 516 mijë lekë total të realizuara në vitin 2021, 132 milion 382 mijë lekë e zënë transporti i mësuesve dhe nxënësve, kurse pjesën tjetër e zënë shpenzimet e tjera operative.

Programi	TOTALI	Programim menaxhimi	A.Baze	A.Mesem
Fakti 602	147,516	14,097	122,781	10,638
Pesha specifike	100%	10%	83%	7%

Nga të dhënat e tabelës duket qartë që peshën specifike më të madhe në realizimin e shpenzimeve e ka arsimit bazë me 83 %, i cili pasohet nga programim menaxhimi me 10 % dhe në fund Arsimit i mesëm me 7 %.

Po e paraqesim grafikisht realizimin sipas programeve



Pesha specifike e zërave të shpenzimeve korente 602 ndaj totalit të realizuar po e paraqesim me tabelë.

Totali	100%
Dieta	1.7%
Telefon, internet	0.2%
Energji ,uje, poste	1.8%
Taksa vendore te bashkise	0.4%
Karburant	1.9%
Materiale kancelarie	0.7%
Blerje tonerash	0.4%
Materiale pastrimi	0.3%
Shpenzime të tjera gjatë vitit	0.6%
Riparim pjese kembimi	0.2%
Taksa dhe siguracion mjete	0.1%
Materiale shtypshkrime,ftesa,certifikata etj	0.0%
Shërbime per mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrave	0.1%
Shërbime të printimit dhe publikimit	0.0%
Qera objekti	0.3%
Vendime gjyqi	1.4%
Transport mesues, nxenes	89.7%

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin:

P.S.BNJ.SH.S
Bajame Skënderaj

DREJTOR
Flutura Meçaj